

KONTRATË SHITJE KUOTË KAPITALI

E lidhur në Tiranë, sot më datë 19/09/2022 (dy mijë e njëzet e dy), ndërmjet:

Shitësi:

Fabjon Hysa; Me nr. Identifikimi GJ302564 , madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

dhe

Blerësi:

Geri Lulaj; Lindur në Vlorë ,më 31.01.1997,me nr. Identifikimi J70131076S, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

MEQENËSE:

Shitësi është ortak zotërues i 1 pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë “OVLA Systems” sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS-NIPT M114230190, me seli në adresën: Tirane ,Rruga Ismail Qemali, Pallati 34, Kati i 5 (më poshtë referuar “Shoqëria”).

Shitësi dëshiron t`i shesë Blerësit dhe ky i fundit dëshiron të blejë nga Shitësi 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar te Shoqërise “OVLA Systems” sh.p.k..

NË BAZË TË SA MË SIPËR, PALËT RANË DAKORD SI VIJON:

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitësi i transferon dhe kalon në pronësinë e vetme ligjore të Blerësit 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërise “OVLA Systems” sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS-NIPT M114230190, dhe Blerësi blen kuotat, kundrejt çmimit të shitjes dhe sipas kushteve e afateve te përcaktuara këtu.
2. Çmimi i shitjes së kuotave të kapitalit është caktuar në marrëveshje ndërmjet palëve në vlerën prej LEK 50 (pesëdhjetë lekë). Cmimi i shitjes i është paguar tërësisht Shitësit nga Blerësi.
3. Me lidhjen e kësaj Kontrate Blerësi behet ortak i vetëm zotërues i 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë “Ovla Systems” dhe njëkohësisht Blerësit i lind e drejta e regjistrimit të pronësisë së vet mbi kuotën ne librin e ortakëve dhe në regjistrin tregtar (QKB) sipas ligjit, ndërsa shitësi largohet nga Shoqëria.

4. Shitësi deklaron dhe garanton se pjesët e kapitalit të transferuara nëpërmjet kësaj Kontrate, janë në pronësinë e vetme e të plotë ligjore të Shitësit dhe janë te lira nga barra, të drejta të tjera reale apo pengje apo të drejta të çfarëdolloji të palëve të treta mbi to.
5. Blerësi deklaron dhe garanton se e njeh gjendjen e Shoqërisë dhe se ka verifikuar regjistrimet e saj kontabël si dhe të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë në tërësi dhe nuk ka ndonjë rezervë apo pretendim. Shitësi shprehimisht një veçanërisht të gjithë detyrimet e Shoqërisë ndaj të tretëve.
6. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të kuotave objekt të kësaj Kontrate në librin e ortakëve si dhe në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas kërkesave të ligjit.

Kontrata u redaktua në gjuhën shqipe dhe në 2 kopje origjinale, dhe pasi u lexua dhe u kuptua prej palëve, u gjet e rregullt dhe në përputhje me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre rregullisht si vijon:

SHITËSI

Fabjon Hysa



BLERËSI

Geri Lulaj

